




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



**KGJK. Nr. 52/2020**  
**Datë: 12 mars 2020**

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK)**, në bazë të nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 12 mars 2020, shqyrtoi masat që duhet të ndermirën për parandalimin e përhapjes së pandemisë Corona Virus (COVID-19), dhe mori këtë:

## V E N D I M

1. Kufizohen përkohësisht veprimtarit gjyqësore ku përfshihet publiku, në të gjitha gjykatat e Republikës së Kosovës, sipas vlerësimit të kryetarit të gjykatës dhe gjyqtarit të çështjes.
2. Në objektet e gjykatave duhet të shmanget prania e publikut.
3. Njëri prind që duhet të kujdeset për fëmijën e vet, mund të lirohet nga puna, sipas kërkesë të parashtruar tek mbikëqyrësi.
4. Ky kufizim do të zgjasë deri më datën 27 mars 2020, përveç nëse vendoset ndryshe.
5. Obligohen Kryetarët e gjykatave të marrin të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e këtij Vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi me datë 12 mars 2020.

Skender ÇOÇAJ  
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

*Kopje e vendimit i dërgohet:*

- Të gjitha Gjykatave të Republikës së Kosovës;
- Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Arkivit.